



DOKUMENT POLITIKASH

**A PO TKURRET SHOQËRIA CIVILE
NË SHQIPËRI?:**

**REAGIMI PREJ SAJ NDAJ
TENDENCAVE AKTUALE**

Ky publikim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) është realizuar në kuadër të projektit “Forcimi i bashkëpunimit të shoqërisë civile brenda rajonit të OSBE-së për stabilizimin e dimensionit njerëzor në kohët e zvogëlimit të hapësirave dhe kundër erozionit të vlerave të përbashkëta dhe mekanizmave shumëpalësh” me mbështetjen financiare të Zyrës Federale të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë. Projekti i zbatuar nga konsorciumi i drejtuar nga KShH, përbëhet nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Serbi; Komiteti Maqedonas i Helsinkit, Maqedonia e Veriut; Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë; Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, Kosovë. Mendimet e shprehura në këtë dokument politikash (*policy paper*) i përkasin vetëm Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese, partnere të konsorciumit.

Përgatiti dokumentin:

Znj. Nosiana Burnazi, Paraligjore/Asistente Projektesh, KShH

Rishikuan:

- 1. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH*
- 2. Znj. Ardita Kolmarku, Drejtuese e Klinikës së Ligjit/Menaxhere Projektesh, KShH*

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

e-mail: office@ahc.org.al

web site: www.ahc.org.al

Përmbajtja

Lista e shkurtimeve	2
1. Hyrje	3
1.2 Kuadri ligjor vendas	3
2. Hapësira e zhvillimit të shoqërisë civile	6
2.1 Politikat e ndërmarra për konsolidimin e rolit të shoqërisë civile	6
2.2 Roli dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile	7
2.3 Politikat financiare	9
2.4 Proceset vendimmarrëse	10
2.5 Bashkëpunimi në nivel vendor	12
3. Rekomandime	14

LISTA E SHKURTIMEVE

AMSHC - Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

BE – Bashkimi Evropian

ILDKPKI - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

KDIMDP - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KQZ – Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

KKSHC - Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

KLGGJ – Këshilli i Lartë Gjyqësor

OJF – Organizatë jofitimprurëse

OJQ – Organizatë joqeveritare

OSHC - Organizatë e Shoqërisë Civile

SHC – Shoqëri civile

TVSH – Tatimi mbi vlerën e shtuar

1. HYRJJE

Në kuadër të zhvillimeve të vrullshme me të cilat po përballet shoqëria në përgjithësi lindin problematika të reja, të cilat kërkojnë reagime të ndryshme nga ato të zakonshmet. Këto ndryshime, prekin njeriun si qenie në vetvete dhe më pas reflektohen edhe tek grupimet që lidhen nga disa interesa të ngjashëm apo të përbashkët. Pikërisht, këto grupime janë ato që marrin trajta të shumëllojshme dhe që sot përkufizohen në mënyrë të përgjithshme nën termin “shoqëri civile”. Ky term filloi të përdorej rreth viteve 1980 dhe lidhej kryesisht me lëvizjet e reja joqeveritare që kishin si synim krijimin e një oponente ndaj regjimeve autoritare të kohës.

Sot, edhe pse regjimet kanë marrë forma më demokratike, roli i shoqërisë civile për të ushtruar ndikimin e vet vazhdon të mbetet po aq thelbësor sa edhe dikur. Grupet e organizuara po evoluojnë në reagimet e tyre ndaj zhvillimeve dhe trendeve të epokës në të cilën jetojmë. Pikërisht, ky Dokument Politikash synon të trajtojë reagimin që po paraqet sektori i shoqërisë civile në Shqipëri ndaj tendencave aktuale me të cilat po përballet. Këto tendenca reflektohen edhe përmes formës ligjore që ligjvënësi ju jep në përgjigje të nevojave të reja që lindin. Duke analizuar kuadrin ligjor në fuqi, zbatueshmërinë e tij deri në këto momente, aktualitetin dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e SHC-së, dokumenti do të rekomandojë masa konkrete që sugjerohet të ndërmerren me qëllim shmangien e kurrjes së rolit të SHC-së në Shqipëri.

1.2 *Kuadri ligjor vendas*

Shoqëria civile (SHC) është komponent kyç i një shoqërie demokratike. Nëpërmjet rolit të saj konstruktiv kritik SHC luan një rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin e një shteti demokratik. Të kuptuarit e trajektorës së SHC-së dhe ndikimit të saj në strukturën politike dhe sociale të vendit tonë është thelbësore në vlerësimin e progresit të vendit drejt një demokracie të qëndrueshme. Nuk ka një përkufizim të mirë përcaktuar se çfarë përfshin koncepti i SHC-së, pasi ai mbart në vetvete një gamë të gjerë grupesh, komunitetesh apo organizatash të cilat funksionojnë në mënyrë të pavarur nga ndikimet qeveritare. Madje në jo pak raste, SHC nënkupton dhe vetë elementët e së drejtës së shprehjes dhe organizimit. SHC ka një ndikim të madh në zhvillimin e vendimmarrjes politike dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve, duke ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie të hapur dhe gjithëpërfshirëse.

Në Shqipëri, SHC në formën e saj aktuale u shfaq në vitet 1990 me rënien e sistemit diktatorial dhe me vendosjen e atij demokratik. Tranzicioni i vendit nga një regjim totalitar në një demokraci ka sjellë ndryshime të rëndësishme. Ndonëse në Shqipëri ka një jetëgjatësi prej më shumë se tri dekadash, procesi transformues është shoqëruar me sfida të njëpasnjëshme. Me gjithë praninë e sfidave dhe pengesave, organizatat jo-qeveritare (OJQ) kanë ndihmuar në zhvillimin dhe forcimin e demokracisë, garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe në përmirësimin e aktivizmit qytetar.

Liria e organizimit garantohet nga Kushtetuta e RSH-së në nenin 46 pika 1 të saj, e cila parashikon shprehimisht se *“Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.”*¹ Po në pikën 3 të këtij neni parashikohet kufizimi i kësaj të drejte, pasi ligji ndalon krijimin dhe funksionimin e organizatave ose shoqatave që ndjekin qëllime antikushtetuese. Ligji Nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar, është kuadri ligjor kryesor e udhëzues i sektorit. Ai përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e OJF-ve, si dhe parashikon garanci konkrete kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të OSHC-ve.

Ligji Nr.80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i miratuar në vitin 2021, përcakton procesin e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrimit për organizatat jofitimprurëse. Me vendimin Nr. 35, datë 26.1.2022 “Për krijimin dhe vënien në funksion të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse” Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) vendosi se regjistri elektronik do të bëhet funksional prej datës 30 dhjetor 2023. Një nga zhvillimet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e këtij ligji e vlerësimin e përputhshmërisë së tij me Kushtetutën, aktet konventore të ratifikuara e standardet më të mira ndërkombëtare, është vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 62, datë 20.11.2023, i disponuar mbi kërkesën e një grupi të OSHC-ve, ndër të cilat Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) për shfuqizimin e disa prej dispozitave të ligjit. Kërkesa u pranua pjesërisht nga Gjykata dhe u vendos shfuqizimi i një sërë parashikimeve lidhur me detyrimin për regjistrim fillestar brenda afatit 30-ditor, i parashikuar në nenin 8 të ligjit, kompetencat e kancelarit si dhe procedurën e ankimit.² Gjykata arriti në përfundimin se ai jo vetëm që nuk buron si i tillë nga legjislacioni në fuqi, por, nga njëra anë sjell detyrime të tjera shtesë për këto subjekte dhe, nga ana tjetër, mosrespektimi i tij çon deri në konsiderimin e tij si shkelje, me pasojë dënimin administrativ me gjobë. Për rrjedhojë, ky parashikim vendos një barrë joproporcionale, veçanërisht për organizatat që synojnë të krijohen rishtazi, duke përbërë kështu një pengesë në drejtim të lirisë së organizimit.³

Ndërkohë, kuadri ligjor ekzistues përfshin edhe Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), si një ent publik qëndror, buxhetor që vepron me qëllim nxitjen, nëpërmjet asistencës financiare e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut.

Rol të rëndësishëm në fuqizimin dhe zhvillimin e SHC-së kanë luajtur edhe një sërë aktorësh të tjerë, duke përmendur legjislativin përfaqësuar nga Kuvendi i RSH-së, si dhe AMSHC-në, KKSHC-në e grupime organizatash në rrjete si Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Rrjeti i monitorimit kundër dhunës me bazë gjinore, etj.

Ky Dokument Politikash u konsultua me disa prej aktorëve të interesit si AMSHC-ja, anëtarë të KKSHC-së dhe përfaqësues të OSHC-ve në një tryezë të përbashkët më datë 31.01.2024, ndërkohë

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

² <https://qzb.gov.al/share/15U1ATWeS46u211VwshxuQ>

³ Vendim nr. 62, datë 20.11.2023.

që sugjerimet dhe rekomandimet e adresuara u vlerësuan me synim reflektimin e atyre proporcionale e adekuate në raport me gjetjet dhe kontekstin e çështjeve të adresuara.

2. HAPËSIRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE

2.1. Politikat e ndërmarra për konsolidimin e rolit të shoqërisë civile

Në raport me detyrimet që ka vendi ynë në përmbushjen e sukseshme të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, me vendimin nr. 539, datë 25.7.2019 Këshilli i Ministrave miratoi “Udhërrëfyesin për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023”. Për të zhvilluar dhe konsoliduar më tej rolin aktiv të shoqërisë civile, udhërrëfyesi ka parashikuar realizimin e disa prioritetëve, si më poshtë:

1. Krijimin dhe ruajtjen e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile;
2. Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të;
3. Përfshirjen e qëndrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes;
4. Sigurimin e kontributit të OSHC-ve në procesin e aderimit në përputhje me praktikat e mira të BE-së;
5. Mbështetjen e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantë në nivel lokal.⁴

Në zbatim të detyrimeve të mësipërme, Komisioni Evropian në raportin e fundit *screening* për Shqipërinë ka theksuar se *kuadri ligjor, rregullator dhe institucional për shoqërinë civile në përgjithësi është i vendosur, por nevojiten një sërë përmirësimesh që kuadri ligjor të zbatohet plotësisht dhe kuadri institucional të bëhet plotësisht funksional. Ligji për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse i miratuar në qershor 2021 do të zbatohet plotësisht vetëm pasi të krijohet Regjistri Elektronik Kombëtar i Organizatave Jofitimprurëse, i cili kërkohet deri në fund të vitit 2023. Deri atëherë, procedurat e regjistrimit sipas ligjit të vitit 2001 mbeten të papërshtatshme pasi OSHC-të duhet të dorëzojnë dosje në letër ose elektronike në gjykatën e rrethit në Tiranë. Regjistri i ri duhet të lehtësojë procesin e regjistrimit dhe të rrisë transparencën.*⁵

Në vlerësimin e KShH-së, kur kanë kaluar më shumë se 3 muaj nga afati fundor i parashikuar për ngritjen e regjistrimit elektronik, masa konkrete duhet të ishin marrë për funksionalitetin e plotë të tij. Gjatë pjesëmarrjes si palë e interesuar në procesin e konsultimit publik të Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike, KShH ka rekomanduar marrjen e hapave konkretë për ndryshimin e masës zbatuese sa i përket kapaciteteve të KLGJ-së për të siguruar funksionimin e sistemit dixhital për regjistrimin e OSHC-ve.⁶ Gjithashtu, vënia në funksion e këtij sistemi duhet të bashkë-shoqërohet me udhëzues ose manual praktik të përdorimit të tij nga ana e palëve të interesit.

⁴ Vendim nr. 539, datë 25.7.2019 “Për miratimin e udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023”.

⁵ European Commission, Screening report Albania, 20/07/2023.

⁶ Shkresa nr. prot. 36, datë 22.01.2024.

2.2 Roli dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Rol të veçantë për funksionimin më të mirë të SHC-së në Shqipëri luan edhe Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), në cilësinë e një organi kolegjal këshillimor, autonom, pranë Këshillit të Ministrave, i cili përbëhet nga 27 anëtarë. Ky organ u krijua dhe funksionon në bazë të ligjit nr.119/2015. Vlen të përmendet se para miratimit të këtij ligji, pati diskutime të ndryshme se sa do të ndikonte ai në forcimin e rolit të shoqërisë civile, në kontribut praktik dhe efektiv, pranë ekzekutivit.⁷ Tashmë rreth 8 vite pas miratimit mund të shihet qartë funksionimi e zbatueshmëria reale e tij, pasi ky ligj ka qënë pjesë edhe e analizave të vazhdueshme të aktorëve të rëndësishëm monitorues ndërkombëtarë.

Sa më sipër, ligji parashikon transparencën përmes publikimeve e vënies në dispozicion të rekomandimeve si një prej parimeve bazë mbi të cilat do të mbështetet funksionimi i KKSHC-së.⁸ Nga kërkimet online në faqen zyrtare të internetit të AMSHC-së apo KKSHC-së, evidentohet se informacioni i reflektuar ndodh që nuk është i përditësuar periodikisht brenda afateve të arsyeshme nga zhvillimi i mbledhjeve, ndërkohë që strukturimi i informacionit dhe aksesit në atë të reflektuar nuk është i lehtë dhe i kuptueshëm tërësisht për publikun.

Nga monitorimi online në faqen zyrtare të KKSHC rezulton se përgjatë vitit 2023 është zhvilluar një Takim Kombëtar me Shoqërinë Civile, gjatë të cilit është diskutuar dhe roli i KKSHC-së në mbështetjen e veprimtarisë së tyre. Nga takimi i datës 24.04.2023, janë ndarë disa pika prioritare, ndër të cilat:

- Taksimi / Qëndrueshmëria Financiare;
- Mjedis më mundësues në aktivizëm, si dhe më mbështetës;
- Mbështetja për organizatat e reja përmes trajnimeve dhe financimit;
- Vizibiliteti dhe imazhi i OSHC-ve;
- Zgjerimi i hapësirave për OSHC-të, etj.

Në vijimësi të takimit të mësipërm, është mbajtur mbledhja e rradhës e KKSHC-së në datën 19.06.2023, ku në rendin e ditës janë përfshirë edhe diskutimet mbi gjetjet e takimit kombëtar, në formën e rekomandimeve të rëndësishme për t'u adresuar nga ana e aktorëve përgjegjës institucionalë si:

1. Futja e shërbimeve të OJF-ve në skemën e dëmshpërblimeve nga dëmet e tërmetit.

⁷ <http://www.panorama.com.al/keshill-kombetar-per-shoqerine-civile-apo-instrument-politik/>

⁸ Neni 4, Ligji Nr. 119/2015 “Pwr krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

2. Të rishikohet ligji për regjistrimin e OJF-ve, i cili është i pazbatueshëm, shumë burrokratik, dhe jo fleksibël (p.sh për modifikime ka problematika me institucionet bankare të nivelit të dytë).
3. Organizatat e shërbimeve të mos trajtohen si biznes edhe në procedurë prokurimi.
4. Pushteti vendor të sigurojë lehtësi për mjedise pune për OJF-të lokale (p.sh financim për infrastrukturë). Qeverisja vendore të jetë pjesë e KKShC – Komunikim dhe konsultim me qeverisjen vendore/të jetë pjesë e mbledhjeve Agjencia e Pushtetit Vendor.
5. Kujdestaria për aftësinë e kufizuar duhet të njihet si vite pune.
6. Të shqyrtohet nga AMShC mundësia e një fushate komunikimi për të reklamuar KKShC-në dhe rolin që anëtarët e shoqërisë civile në Këshill mund të kenë për rekomandimin e politikave. Të shtohet gjithashtu roli mbështetës që AMShC ka si sekretariat i KKShC-së.
7. Mjedisi ligjor të jetë lehtësues dhe mbështetës në lidhje me taksimin, sponsorizimet, gjobat, dhe mbështetjet financiare.

KShH vlerëson se çështjet dhe rekomandimet prioritare të adresuara në këtë mbledhje, duhet të ndiqen proaktivisht nga ana e anëtarëve përfaqësues të sektorit të shoqërisë civile në KKSHC. Plan masash për ndjekjen e mëtejshme të tyre në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë sugjerohet të hartohet me synim reflektimin e indikatorëve të qartë e rezultateve konkrete që do të arrihen nëpërmjet advokimit e lobimit sistematik me autoritetet përgjegjëse në rang vendor e qendror.

Sa i përket personalitetit juridik dhe përbërjes së këtij organi, ligji ka parashikuar një minimum mbledhjesh prej 3 takimeve në vit e një grup me 27 anëtarë, ku 13 janë përfaqësues të institucioneve publike, 13 përfaqësues të OJF-ve dhe 1 përfaqësues nga komuniteti i biznesit.⁹

Në vlerësimin e KShH-së, numri i barabartë i përfaqësuesve të institucioneve publike me atë të përfaqësuesve të OJF-ve, nuk është në propocion me vetë qëllimin për të cilin është krijuar ky organizëm, pasi në fokus të tij duhet të ishte zhvillimi i bashkëpunimit institucional i OSHC-ve me institucionet publike dhe ligji duhet të përbënte një instrument në dobi të angazhimit e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në një masë më të madhe e më të gjerë në raport me atë të institucioneve publike. Gjithashtu, parashikimi i minimumit të mbledhjeve (3 herë në vit) përbën një standard relativisht të ulët dhe joefektiv për organizimin e këtij organi, pasi politikat e ndërmarra si nga pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ janë tepër dinamike e të shumëllojshme dhe kërkojnë një angazhim më të madh të KKSHC-së për të dhënë rekomandime, komente e sugjerime aktuale në një kohë sa më të shpejtë.

Së treti, vlen të përmendet se lidhur me funksionimin e KKSHC-së është shprehur edhe BE-ja. Në raportin e Komisionit Evropian thuhet se ky organ “*mbetet i dobët, duke përfshirë aftësinë e tij për*

⁹ Ligj nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e këshillit kombëtar për shoqërinë civile”

të shprehur prioritetet e OSHC-ve në proceset e politikëbërjes dhe është funksional me vështirësi.”¹⁰ Përgjatë vitit 2022, KKSHC-ja ka organizuar në total dy mbledhje, përkatësisht më datë 22.06.2022, si dhe 15.11.2022. Ndërsa në vitin 2023 janë zhvilluar 3 mbledhje, ku ndër to përfshihet organizimi i takimit kombëtar të shoqërisë civile, më datë 24.04.2023.

2.3. Politikat financiare

Në zhvillimin e hapësirës së SHC-së në Shqipëri, kanë ndikuar drejtpërsëdrejti edhe politikat financiare të ndërmarra në përputhje me qëllimet dhe prioritetet respektive të pushtetit ekzekutiv. Legjislacioni aktual në fuqi parashikon përjashtimin nga tatimi mbi fitimin të entiteteve që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre.¹¹ Nga ana tjetër, lidhur me fushën e zbatimit të legjislacionit mbi TVSH-në, në pikën 2 të nenit 8 të udhëzimit nr.6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se organizatat jofitimprurëse nuk konsiderohen persona të tatueshëm dhe nuk detyrohen të regjistrohen për TVSH-në kur përfitojnë pagesa të tilla si kuotizacionet, fondet, grantet, donacionet prej donatorëve për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës dhe si kundërvlerë të këtyre pagesave të përfituara nuk i kryejnë donatorëve një furnizim malli ose shërbimi, por pagesat e përfituara i përdorin për të realizuar qëllimin e veprimtarisë së tyre.¹²

AMSHC-ja rezulton organi kryesor publik që ofron mbështetje financiare për shoqërinë civile, përmes granteve për projekte dhe granteve institucionale. Në vitin 2022, Agjencia dha 62 grante në vlerën 821,682 euro, nga 943,237 euro në 2021, shifra këto që reflektojnë një reduktim në masën 13%.¹³ Ndërsa, sipas Raportit Vjetor për vitin 2022 të AMSHC-së, projektet janë shtrirë në 12 qarqe të vendit, me vlerë totale 932,071 Euro. Situata e financimeve përbën një element të rëndësishëm lidhur me funksionimin sa më efektiv të OSHC-ve, por edhe garantimin efikas të pavarësisë së tyre gjatë ndjekjes së kauzave të caktuara. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me statutin dhe misionin e AMSHC-së, është shpallur thirrja për shprehje për asistencë financiare më 31 maj - 1 korrik 2022, bazuar në prioritetet e përcaktuara nga Bordi Mbikëqyrës. Janë përcaktuar 4 fusha, si më poshtë:

1. Shëndetësia dhe Shërbimet Sociale; (janë përzgjedhur 13 projekte fituese)
2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI; (janë përzgjedhur 9 projekte fituese)
3. Mjedisi, dhe Zhvillimi i qëndrueshëm; (janë përzgjedhur 20 projekte fituese)
4. Arsimi dhe Integrimi European (janë përzgjedhur 16 projekte fituese).
5. Janë përzgjedhur edhe 4 projekte, të cilat prekin më shumë se një fushë prioritare.

¹⁰ European Commission, Screening report Albania, 20/07/2023.

¹¹ Ligj nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

¹² Udhëzim nr.6, datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

¹³ European Commission, Screening report Albania, 20/07/2023.

Komisioni Evropian, lidhur me këtë aspekt është shprehur se *“financimi publik për OSHC-të nuk lejon të sigurohet qëndrueshmëria e tyre apo e aktiviteteve të tyre, veçanërisht në rolin e tyre si ofrues të shërbimeve. Regjimi tatimor për OSHC-të është i paplotë pasi nuk lejon donacione individuale. Kuadri ligjor nuk ofron stimuj tatimorë për donacionet e korporatave ose individuale për OSHC-të.”*¹⁴ Në vlerësim të të dhënave të grumbulluara, qëndrueshmëria financiare e OSHC-ve nëpërmjet granteve nga AMSHC-ja do të ishte më e mirë-menaxhueshme dhe në mënyrë efikase e garantuar, nëse OSHC-ve iu sigurohet hapësira e nevojshme për konsultim dhe dhënie mendimesh e opinionesh lidhur me prioritetet kyçe që mund të udhëzojnë thirrjet e hapura vijuese. Gjithashtu, në këtë këndvështrim, amendime konkrete ligjore janë të nevojshme me synim ofrimin e mundësive më të përshtatshme dhe efikase financimi e operimi për OSHC-të, duke ju siguruar atyre një qëndrueshmëri në përmbushje të misioneve të tyre, të tilla si:

KShH beson që për të shmangur ndërvarësinë e misioneve të OSHC-ve sipas thirrjeve dhe orientimeve të donatorëve të ndryshëm, do të ishte e nevojshme që të kryhej një studim i mirëfilltë për të parë se cilat janë fushat kryesore të interesit për të cilat OSHC-të në vend kanë interesin dhe ekspertizën e duhur. Në vijim, AMSHC-ja mund të ofrojë marzh më të lartë financimi për disa prej këtyre fushave prioritare.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se në Gjermani në fillim të dhjetorit 2022, qeveria federale miratoi draftin e Aktit të Promovimit të Demokracisë, përmes të cilit ofrohet një program financimi për OSHC-të që punojnë për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.¹⁵

Së treti, në vlerësim të KShH-së, gjatë hartimit të politikave të reja duhen mbajtur në konsideratë edhe praktikatat më të mira të ndjekura nga vendet e rajonit, me të cilat Shqipëria ka një ngjashmëri më të lartë në aspektin social dhe ekonomik. Që prej vitit 2017, në Bullgari zbatohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Aktiviteteve Rinore sipas nenit 10a të Aktit të Lojërave të Fatit, i cili është një mekanizëm për financimin e projekteve rinore si pjesë e zbatimit të politikës kombëtare rinore me një buxhet që kalon 5 milionë BGN në vit. Ky program pati si pikënisje trendet negative të konstatuara nga të rinjtë të cilit shfaqnin sjellje agresive dhe forma të ndryshme të varësive.¹⁶

2.4. Proceset vendimmarrëse

Roli i SHC-së në proceset vendimmarrëse përbën gjithashtu një element të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë pasi shërben si një tregues i rëndësishëm i nivelit të transparencës dhe demokracisë. Për një zhvillim më efektiv dhe të vazhdueshëm të SHC-së ka vlerë mbështetja e organizatave joqeveritare, jo vetëm në aspektin financiar por edhe në garantimin e gjithëpërfshirjes konstruktive e jo formale, si nga ekzekutivi edhe nga legjislativi. Në këtë aspekt, aktorë të SHC-së mund të kontribuojnë në përmirësimin e projekt-akteve (përfshirë projektvendime ose të projektligjeve) e që kanë interes publik dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve të sanksionuara

¹⁴ European Commission, Screening report Albania, 20/07/2023.

¹⁵ Civic-Space-Report-2023-European-Civic-Forum.pdf

¹⁶ National program for implementation of youth activities under Article 10a of the Gambling Law (nism.bg)

në Kushtetutë, në mënyrë të veçantë kur në to parashikohet kufizimi i këtyre të drejtave. Kështu, p.sh: komisionet e përhershme parlamentare mund të nxisin organizimin e seancave dëgjimore me përfaqësues të SHC-së, për çështje të karakterit sensitiv, që ngrenë nevojën e diskutimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të prodhuara nga aktivizmi i këtyre aktorëve në terren.

KShH ka shprehur vlerësim për hapat e ndërmarrë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në konsultimin e projekt-akteve të ndryshme që prekin fusha të interesit, të ndërlidhura me misionin e OSHC-ve. Gjithashtu, të konsideruara pozitive janë edhe tryezat e përbashkëta të diskutimeve e konsultimeve të organizuara në kuadër të tryezave Platformës së Partneritetit, ku roli dhe aktivizmi i aktorëve të SHC-së konsiderohet i lartë. Niveli i pjesëmarrjes së aktorëve në disa prej këtyre mekanizmave është konsideruar relativisht i ulët, e si rrjedhojë do të vlerësohej marrja e hapave konkretë për krijimin e urave të komunikimit që krijojnë gjithëpërfshirje. Databazat e përditësuara të të dhënave të harmonizuara ndërmjet Regjistrimit Elektronik të OSHC-ve, AMSHC-së dhe aktorëve institucionalë të cilët kanë kompetenca në konsultimin e projekt-akteve të ndryshme, do të garantonin përfshirjen e përfaqësuesve të OSHC-ve që përfaqësojnë interesat e grupeve vulnerabël, grupet informale të qytetarëve, si dhe atyre të lokalizuar në zona rurale të vendit.

Përpos angazhimit në fazën konsultative të procesit, jemi të mendimit se me gjithë hapat dhe nismat pozitive të ndërmarrë, problematike mbeten diskutimet me karakter më së shumti formal si dhe njoftimet në një hark të shkurtër kohor mbi axhendën e diskutimeve dhe projekt-aktet objekt konsultimi, duke mos ju lënë kështu kohë mjaftueshëm grupeve të interesit për të ofruar kontribut cilësor me shkrim. Ndërkohë, siç më herët, KShH ka sugjeruar, ritheksohet nevoja për marrjen e masave nga ana e ekzekutivit dhe legjislativit për hartimin sistematik të tabelës së vlerësimit të masës së implementimit të komenteve/sugjerimeve të adresuara nga ana e palëve të interesit. Mosnjohja me të dhënat e nivelit të zbatueshmërisë së sugjerimeve të adresuara, tkurr pjesëmarrjen e organizatave në mënyrë periodike, për shkak të kufizimit në burime njerëzore dhe financiare, por edhe për shkak të mungesës së besueshmërisë për analizimin e reflektimin e drejtë mbi pjesëmarrjen e tyre në këtë proces.

Këto problematika të hasura praktikisht nga ana e OSHC-ve janë sjellë në vëmendje edhe përmes qëndrimeve e rekomandimeve të adresuara nga ana e Komisionit Europian, e më konkretisht është theksuar se, *“Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe grupet e interesit mbetën formale, përfshirë këtu edhe në kontekstin e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian të ngritur nën kujdesin e Kuvendit. Ndërveprimi me OJQ-të/OSHC-të dhe grupet e interesit po ndodh në nivel formal, megjithëse mund të intensifikohet më tej dhe të zhvillohet në shkëmbime më kuptimplota. Veçanërisht kur bëhet fjalë për konsultimet për iniciativat dhe proceset e reja legjislative, OJQ-ve/OSHC-ve dhe grupeve të interesit duhet t'u jepet fuqizim më i madh dhe të përfshihen në kohë për të dhënë kontribute kuptimplota.”*¹⁷

¹⁷ European Commission, Screening report Albania, 20/07/2023.

Gjithashtu, në nenin 103 të Rregullores së Kuvendit është parashikuar dhënia e mendimit me shkrim nga ana e OSHC-ve, kur çmohet e nevojshme në rastin e diskutimit të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, për çështje dhe fusha që i mbulon kompetenca institucionale. Në zbatim të kësaj dispozite, gjatë vitit 2021 KShH ka luajtur një rol proaktiv në adresimin e komenteve/sugjerimeve pas njohjes me draft-raportet vjetore të hartuara e të depozituara në Kuvend në kuadër të raportimit nga institucionet si: KLGJ, ILDKPKI, Avokati i Popullit, KDIMDP, KQZ, etj.¹⁸ Korniza ligjore duket se i jep mundësi praktike bashkëpunimi OSHC-ve për të qenë prezente në jetën politike dhe proceset vendimmarrëse. Megjithatë, sfidat kryesore lidhen me zbatimin efektiv në praktikë të këtyre parashikimeve ligjore në fuqi.

2.5 Bashkëpunimi në nivel vendor

Grupime apo organizata të ndryshme të cilat kanë misione më të konkretizuara e specifike mbi një komunitet apo territor të caktuar në përputhje me nevojat dhe interesat që ato paraqesin pasqyrojnë një anë të rëndësishme të sektorit të SHC-së. Në fakt çdo OSHC nëpërmjet veprimtarisë së saj do të duhet të ushtronte një lloj impakti pozitiv ndaj organeve publike, me qëllim parandalimin ekryerjes së shkeljeve ligjore që mund të cënojnë liritë dhe të drejtat e shtetasve, e në rast të kundërt, rivendosjen në vend të të drejtave të cënuara e kufizimin e përhapjes së mëtejshme të cënimit. Një angazhim i këtij niveli nga organizatat lokale, e kryesisht ato të natyrës grassroots paraqitet i vështirë, për shkak të sfidave e vështirësive me të cilat ato përballen si burime të kufizuara njerëzore, paqëndrueshmëri financiare dhe heterogjeniteti i aktiviteteve i përshtatur në raport me strategjitë e komunitetit të donatorëve. Ndërkohë, OSHC-të që veprojnë me komunitete konkrete, kryesisht me ato të marginalizuara dhe vulnerabël, apo që e shtrijnë aktivitetin e tyre në zona me popullatë të kategorizuar nga kushte të vështira socio-ekonomike, e prekur nga migracioni dhe emigracioni, e kanë përherë e më të vështirë të veprojnë e të ndërmarrin nisma afatgjata në përputhje me misionet e tyre.

Me synim, reduktimin sadopak e pasojës dhe impaktit të këtyre sfidave e vështirësive, vlerësojmë se hapa konkretë duhet të ndërmerren në krijimin e hapësirave për rritjen e kapaciteteve të organizatave në rekrutimin e burimeve njerëzore të profilizuara në fushën e projekteve dhe menaxhimit të granteve, e rritjes së fondeve. Lind nevoja për nxitjen e proaktivitetit dhe bashkëpunimit nëpërmjet krijimit të rrjetëzimeve e grupimeve të qëndrueshme, të cilat kanë kapacitete dhe tagra reaguese të menjëhershme ndaj zhvillimeve sociale, kulturore apo politike në vend. Promovimi i rolit e aktivitetit të këtyre organizatave nëpërmjet mjeteve të komunikimit teknologjik, periodikisht, i shërben pozitivisht krijimit të hapësirave për vetë-evidentimin e tyre në raport me autoritetet publike, të cilat mund të lehtësojnë aksesin e përfshirjes së organizatave në procese vendimmarrëse dhe legjislative në nivel vendor e qendror.

Fenomeni *brain drain* (largimi i trurit) i cili ka impaktuar në masë vendet e Ballkanit Perëndimor, ka ndikuar sektorin vendas të shoqërisë civile. Emigrimi jashtë vendit i një pjese të të rinjve dhe personave të kualifikuar, ka krijuar tashmë praktikën provizore të angazhimit *remotely* (në

¹⁸ <https://ahc.org.al/publikime/oponenca-ligjore/>

distancë) të të rinjve nga vendet në të cilat ata po ndjekin studimet apo janë shpërngulur për vijimin e jetesës së tyre.

Në vendin tonë, mundësi financimi afatgjatë nga ana e Njësive të Qeverisjes Vendore nuk janë parashikuar ndaj OSHC-ve. Rezulton se bashkëpunimi i Bashkive me OSHC-të realizohet në bazë të thirrjeve publike që publikohen për projekte rajonale siç është ReLoad. Një mbështetje e rëndësishme e OSHC-ve në nivel kombëtar, krahas thirrjeve për grante nga AMSHC, është edhe mbështetja që ofrohet kundrejt autorizimit nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për ofrimin e shërbimeve parësore të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. KShH, në mars të këtij viti ka adresuar një sërë komentesh lidhur me përmbajtjen e Projektvendimit “Për disa shtgesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 55, datë 06.02.2019, të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti.”¹⁹ KShH ka rekomanduar që të merret në konsideratë depozitimi i kërkesave për autorizimin edhe në rrugë postare, duke mos përjashtuar vijueshmërinë e ndjekjes së procesit për plotësim dokumentacioni nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ndaj organeve publike përgjegjëse. Gjithashtu, u sugjerua edhe parashikimi i afateve konkrete lidhur me ofrimin e shërbimi përkatës nga AKSHI për aksesimin e platformës qeveritare e-Albania.

Në nivel vendor, vlerësojmë se do të ishte e nevojshme marrja e masave konkrete nga ana e njësive të qeverisjes vendore për ndërmarrjen e takimeve periodike ndërsektoriale, me përfaqësues të OSHC-ve, të komuniteteve fetare, të mediave, aktorë institucionalë, me synim promovimin e aktiviteteve dhe rolit të grupeve informale, krijimin e forcimin e urave të bashkëpunimit dhe bashkë-koordinimin me grupet informale të qytetarëve, me synim diskutimin mbi shqetësimet, sfidat, pengesat por edhe kauzat sociale të cilat sugjerohen të ndiqen më tej.

¹⁹ Përmes shkresës nr. Prot. 147, datë 06.03.2024.

3. REKOMANDIME

- Sugjerohet marrja e masave nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe KLGJ-së për vënien në funksionalitet të Regjistrimit Elektronik Kombëtar të OJF-ve, pasi vonesa prej rreth 3 muajsh nga vendimmarrja e ngritjes së tij, impakton ekonomizimin dhe efikasitetin e procedurave të parashikuara për t'u ndjekur nga ana e OJF-ve.
- Gjithashtu KShH i rekomandon KLGJ-së marrjen e masave për reflektimin e ndryshimeve të nevojshme në formatin e formulari tip të pezullimit të kërkesës për regjistrim, në përputhje me nenin 29 të ligjit nr. 80/2021, pasi shprehja “kancelar” është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, përmes vendimit nr. 62, datë 20.11.2023.
- Rekomandojmë marrjen e masave nga ana e Kuvendit të RSH-së për amendimin e ligjit nr. 119/2015, me synim adresimin në mënyrë më të plotë dhe gjithëpërfshirëse të nevojave të SHC-së, siç janë nevoja për ndryshimin e numrit të përfaqësuesve të sektorit të SHC-së në KKSHC drejt një trendi rritës, garantimin e plotë të transparencës përmes publikimit sistematik të opinioneve e vendimmarrjeve të marra. Në këtë kuadër, sugjerojmë miratimin e amendimeve të nevojshme, pasi duhet të ketë një numër më të madh të përfaqësuesve të shoqërisë civile në krahasim me ata të institucioneve publike, të cilët mund ti shprehin pikëpamjet e rekomandimet e tyre përmes Ministrive përkatëse pa qënë nevoja që të jenë pjesë e strukturës së KKSHC-së.
- I sugjerojmë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë marrjen e masave për zhvillimin e përditësimin e mekanizmave të transparencës, si dhe identifikimin e formave të përshtatshme e lehtësisht të aksesueshme për të garantuar ndërveprim efektiv me shoqërinë civile. Monitorimi i afateve të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, të parashikuara për garantimin e kohës së nevojshme ndaj grupeve të interesit të cilat kanë depozituar nisma ligjvënëse ose peticione drejt Kuvendit, do t'i shërbente shqyrtimit efikas dhe cilësor të tyre nga ana e Komisioneve parlamentare përkatëse.
- Forcimi i mëtejshëm i rolit të grupit të përhershëm tematik të shoqërisë civile që funksionon pranë Komisionit të Integritimit Evropian, do të ndikonte pozitivisht proceset legislative të Kuvendit. Nën këtë praktikë, sugjerojmë krijimin e hapësirës për ngritjen e grupeve të përhershme tematike edhe pranë Komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit, me qëllim përfshirjen e përfaqësuesve të sektorit të shoqërisë civile në mënyrë sistematike me kontribute konkrete në pushtetin ligjvënës.
- I rekomandojmë KKSHC-së dhe AMSHC-së marrjen e masave konkrete me qëllim përditësimin e faqeve zyrtare të këtyre organizmave të rëndësishëm për sektorin e shoqërisë civile, duke i pasuruar në kohë reale me procesverbalet e vendimmarrjet e mbledhjeve të zhvilluara, si dhe hartimin e planeve të punës objektive për ndjekjen e mëtejshme të rekomandimeve konkrete të adresuara nga mbledhjet e zhvilluara.

- Në respektim të nenit 4 të ligjit nr/ 119/2015, i sugjerojmë Këshillit të Ministrave marrjen e masave për publikimin e rekomandimeve të qënësishme të rezultuara nga mbledhjet e KKSHC-së, me qëllim garantimin funksional të parimit të transparencës.
- Me synim zgjerimin e rrethit të subjekteve aplikuese të skemës së grant-dhënies të AMSHC-së, sugjerojmë marrjen e masave nga ana e Kuvendit për amendimin e nenit 4 të ligjit nr. 10093, dt. 09.03.2009. Përfshirja e grupeve informale si subjekte përfituese mbështetëse, vlerësojmë se do t'i shërbente pozitivisht rritjes së kapaciteteve të tyre, si dhe fuqizimit të rolit e aktivitetit të tyre në drejtim të promovimit e mbështetjes së kauzave të rëndësishme sociale.
- I sugjerojmë organeve të pushtetit vendor marrjen e masave për krijimin e planeve të përbashkëta të bashkëpunimit me OSHC-të lokale. Zhvillimi i takimeve sistematike të përbashkëta midis përfaqësuesve të KKSHC-së dhe atyre të pushtetit vendor, vlerësojmë se do të ndikonte pozitivisht në adresimin e rekomandimit të KKSHC-së të mbledhjes së datës 24.04.2023, për diskutimin mbi hapësirat e nevojshme për financim në infrasktrukturë. Masat e marra në funksion të promovimit të misionëve të OSHC-ve me ekspertizë, stabilitet e përfshirje të qëndrueshme e të gjerë në nivel kombëtar, vlerësojmë se do t'i shërbenin krijimit të shembujve pozitivë e frymëzues edhe për organizatat lokale.